



RADIO BULLGARIA

БЪЛГАРСКИ

РУССКИ

ENGLISH

DEUTSCH

FRANÇAIS

ESPAÑOL

СРПСКИ

ΕΛΛΗΝΙΚΑ

SHQIP

TÛRHÇE

تورکجه

RADIO NË INTERNET

Ⓜ️ КОРУЗИОНТ

Ⓜ️ КРУСТО БОТЕВ

Ⓜ️ БЪЛГАРСКИ

Ⓜ️ РУССКИ

Ⓜ️ ENGLISH

Ⓜ️ DEUTSCH

Ⓜ️ FRANÇAIS

Ⓜ️ ESPAÑOL

Ⓜ️ СРПСКИ

Ⓜ️ ΕΛΛΗΝΙΚΑ

Ⓜ️ SHQIP

Ⓜ️ TÛRHÇE

## Kultura dhe shkenca

Botuar me: tetor 12, 2004, 1:39.MD BG  
Rifreskuar me: tetor 14, 2004, 5:50.MD BG

📄 Ruaj 🗨️ Shtyp ✉️ Dergo

### Roboti humanoid bullgar Kibertron fitoi nje cmim evropian per inovacione

Salloni i inovacioneve Inovact /www.Inovact.com/ ne qytetin francez Reims eshte nder te paketet ne Evrope, te cilet jane kushtuar ndermarrjeve, qe aplikojne inovacionet ne veprimtarine e tyre. Prej 5 deri me 7 tetor ne kete qytet u takuan mbi 200 ndermarrje nga dhjetra vende evropiane. Ne kohen e sallonit Inovact ishin dorezuar dhe Cmimet evropiane te inovacioneve /Trophees europeens de l'innovation /European Innovation Awards/. Nje prej ketyre cmimeve iu dha projekti bullgar te robotit humanoid Kibertron. Ai eshte krijese e tre studenteve – Ahmed Mercev, Antoni Stavrev dhe Lubomir Sllavov, te ndihmuar nga nje ekip shkencetaresh.

“Studimet shkencore dhe inovacionet do te paracaktojne te ardhmen e Evropes” – deklaroi ne ceremonine e dorezimit te cmimeve komisar i evropian i studimeve shkencore Philippe Busquin, ndersa per Radio Bullgarine ai shtoi:

“Hapsira shkencore evropiane nuk duhet te futet ne caqe gjeografike, sepse behet fjale per nje gjendje shpirtrore ne Evropen e zgjeruar, ne te cilen do te perfishihet se shpejti dhe Bullagria. Vendi juaj ka tradita te mira ne studimet shkencore. Une njohe disa profesore bullgare dhe perfaqesues te Akademise bullgare te sheknceve. Gezohem se ketu u njoha dhe me njerez te rinj qe merren me shkence dhe inovacione, qe krijojne produkte dhe vende te reja te punes, ndersa kjo eshte shume e rendesishme per Evrope”.

Gjate shtatorit te ketij viti projekti Kibertron u klasifikua nga revista elektronike amerikane “Androidworld” /http://androidworld.com/ ne vendin e 6 ne bote pas projekteve te kompanive japoneze Honda motor dhe Sony. Nje sukses i mrrekullueshem i nje projekti evropian ne fushen ku japonezet dominojne.


Cilat jane perparsite e Kibertronit? Ndryshe nga robotet e tjere ai nuk e perdor intrelektin artificial te kompytereve tradicionale. Por nje intelekt natyral, ne bazen e nje teorie te re universale per natyren e kohes

КЕРКО

HARTA E FAQES

ПОИМЉЕ

ПА КОНТАКТОИ



Ekipi i studenteve qe e shpiken robotin bashke me dy eksperte shkencore

Roboti Kibertron

dhe komunikacioneve ne sistemet, ligjet e te cilave jane te vlefshme si per Universin, ashtu dhe per njeriun. Keshtu shmangjet "gracka" e kerkimit te kompytereve gjithnje e me te fuqishem dhe kursehet energji.

"Ne bazen e Kibertronit eshte i ashstuqjatur i "komjuter kaotik", nepermjet te cilit vendosim nje rend te vogel ne kaosin – shpjegon Ahmed Mercevi. Ne te njejtin parim punon dhe mendimi njerezor. Per mekaniken e Kibertronit kemi krijuar nje muskull elektro-mekanik, i cili imiton muskujt e njeriut. Kibertroni mund te levizet, te vrapoje, te perulet. Pavec sistemit qendror nervor, i cili eshte intelekti i tij, Kibertroni si njeriu, ka dhe nje sistem te dyte nervor, i cili formon reflekset e tij.

Si njeriu, ashtu edhe Kibertroni, qe te mund te kryeje ndonje operacion te caktuar duhet te trajnohet per kete. Por pas kesaj softweri mund te aplikohet ne shume raste. Idea eshte qe ky lloje robotesh te zvendesojne njeriun ne punen ne mjedise te demshme ose te rrezikshme.

Autore: Maria Dimitrova

Pergatiti ne shqip: Gjullka Ilieva

 Ruaj

 Shtyp

 Dergo

#### AKCENTET

Botuar me: nentor 01, 2004, 1:42.MD BG



#### AKTUALITETE

Botuar me: tetor 27, 2004, 3:02.MD BG



Botuar me: tetor 27, 2004, 2:56.MD BG



Botuar me: tetor 06, 2004, 1:29.MD BG



Botuar me: tetor 04, 2004, 1:44.MD BG

